

lajmi.net

# Policia arreston dy serbë në Kllokot, gjuajtën me kallashnikov Natën e Krishtlindjeve

LAJME

LAJMI I FUNDIT

lajmi.net

Më afër lexuesit.

12/01/2023 20:11

f

t

l

Drejtoria Rajonale e Policisë Gjilan, ka identifikuar tre të dyshuar serb kosovar nga të cilët ka arrestuar dy nga ta A.S. (1992) dhe D.M.(1996) pasi të njëjtit dyshohet se në Kllokot me rastin e festimit të festës së „Krishtlindjeve Ortodokse” kanë shtënë me armë zjarri duke shkaktuar rrezik të përgjithshëm.

I dyshuari i tretë po ashtu serb kosovar nuk është arritur që të takohet dhe i njëjti është në kërkim policor.

“Drejtoria Rajonale e Policisë Gjilan, Njësi i Hetimeve Rajonale Gjilan pas marrjes së informatave përmes rrugëve operative, sigurimit dhe analizimit të video inçizimeve ka identifikuar tre të dyshuar serb kosovar nga të cilët ka arrestuar dy nga ta A.S. (1992) dhe D.M. (1996) pasi të njëjtit dyshohet se me datën 07.01.2023 në Kllokot rreth mesnatës me rastin e festimit të festës së „Krishtlindjeve Ortodokse” në Kllokot kanë shtënë me armë zjarri duke shkaktuar rrezik të përgjithshëm. I dyshuari i tretë po ashtu serb kosovar nuk është arritur që të takohet dhe i njëjti është në kërkim policor. Me urdhëresë të Gjyqtarit të Procedurës Paraprake nga kjo njësi është realizuar kontrollë në tri lokacione të ndryshme, ndërsa dy armë automatike AK47 të cilat dyshohet se janë përdorur në këtë rast nuk është arritur që të gjenden aktualisht”, thuhet në njoftimin e policisë.

Dy të dyshuarit e lartcekur pas shoqërimit në zyrat e Njësisë së Hetimeve Rajonale Gjilan janë intervistuar në bazë të procedurave ligjore.

Në lidhje me rastin është njoftuar Prokurori i Shtetit i cili ndaj dy të dyshuarve ka lëshuar masën e ndalimit për 48 orë dhe ndaj tyre do të ngritët kallëzim penal për veprat penale “Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm”, “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe “Përdorimi i armës” dhe rasti do të procedohet në Prokurorinë Themelore. **/Lajmi.net/**


## Artikuj të ngjashëm



January 13, 2023  
Joseph: S'ka dyshim që Asociacioni është në rendin e ditës së...



January 13, 2023  
Zyrtarët e Listës Serbe pjesëmarrës në festën jokushtetuese në Banjallukë...



January 13, 2023  
Eksplozivi në Zhur që vrau policin, Iran Badallaj thotë se u...



January 13, 2023  
Limaj, Lushtaku, Nura: Ish-akterët e UÇK-së mblidhen në shtëpinë e deputetit...



January 13, 2023  
Prishtinasja tenton t'ia vë zjarrin shtëpisë, e djeg veten



January 13, 2023  
Zëdhënësi i Qeverisë: Asociacioni s'është çështje mes Kosovës dhe SHBA-ve...

## Other Links

- Fact-Checking Policy
- Ethics Policy
- Corrections Policy
- Ownership & Funding Information
- Editorial Team Information